



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 06 Tetor 2023

Nr: 798

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE REGJISTRUAR ME NR. 02 ID DHE
03 ID NGA ZJ. ALBANA VOKSHI, DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË NDAJ Z. EDUART
SPAHIU, DREJTOR I UJËSJELLËSIT KUKËS DHE DISA PREJ FUNKSIONARËVE PUBLIKË
SHTETËROR PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS
24 SHTATOR 2023**

Sot më datë 06 Tetor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

KËRKUES: Zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë

SUBJEKT: Z. Eduard Spahiu, Drejtor i Ujësjellësit, Kukës
Disa funksionarëve shtetëror

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i denoncimeve nr. 02 ID dhe 03 ID

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Data: 6 Tetor 2023

Nr: 798

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 02 ID dhe nr. 03 ID nga zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.08.2023, ka caktuar datën 24 Shtator 2023, si datën për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka administruar nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve, denoncimin gjeneruar në sistem me nr. 14479 dhe nr. 14480, datë 24.09.2023, të zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, të cilët janë regjistruar me nr. 02 ID dhe 03 ID, në regjistrin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

1. Në denoncimin regjistruar me nr. 02 ID, pretendohet se: *“Drejtori i Ujësjiellit Eduard Spahiu ka qëndruar në ambjentet e QV Mamëz, Kolsh, duke kontrolluar dhe intimiduar votuesit. Nëpërmjet Sistemit të Patronazhimit PS ka dhunuar votën e qytetarëve.”*

Bashkëlidhur denoncimit në cilësinë e provave janë dërguar fotot si më poshtë:

- [5a11f72f-f3f8-4778-9e47-a840f6533026.jpeg](#)
- [ed2eac87-127c-4d20-b864-489a2c4b41af.jpeg](#)
- [ba0435c0-2407-4572-9872-10f38b4ae939.jpeg](#)
- [3433012b-73c5-4118-8ae0-25daabeecb94.jpeg](#)

2. Në denoncimin regjistruar me nr. 03 ID, pretendohet se:

“Në përpjekje për të kontrolluar, devijuar, manipuluar dhe shantazuar votën, drejtorë shkollash e Hipoteke, të postës apo doganierë, janë fotografuar nga qytetarë kuksianë në qendrat e votimit.

Në një system patronazhimi, drejtuesit e institucioneve shtetërore qëndrojnë brenda perimetrit 150 m, të përcaktuar nga KQZ, duke intimiduar qytetarët.

Kodi Zgjedhor dhe vendimet e KQZ e thonë qartë : Nuk lejohen persona të paautorizuar brenda një perimetri prej 150 m rreth Qenrave të Votimit”.

Bashkëlidhur denoncimit në cilësinë e provave janë dërguar fotoT si më poshtë:

- [194fe56c-cf1c-4670-97c4-c5944c227eb5.jpeg](#)
- [cf867e83-f86c-4a05-8a49-ac1522b5a6ae.jpeg](#)
- [c14528d4-1082-4c69-9de9-fcc532e239f7.jpeg](#)

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 798
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 02 ID dhe nr. 03 ID nga zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”

- [742cd2ea-5c67-44e0-87f3-5411d07f6dcb.jpeg](#)
- [IMG_4483.jpeg](#)

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjet, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljen e mundshme.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë paraqitur 2 (dy) denoncime të cilat të cilat kanë të njëjtin objekt dhe shqyrtimi i tyre bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vendos shqyrtimin së bashku të këtyre denoncimeve.

Në vijim të hetimit administrativ, palët në procesin administrativ, u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të datës 06.10.2023, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike nuk u paraqit asnjë prej palëve të njoftuara.

Pasi u njoha me të gjitha faktet dhe rrethanat, pas administrimit të fotove, nuk provohet qartësisht ekzistenca e shkeljes së pretenduar.

Denoncuesi në vijim të hetimit administrativ nuk paraqiti fakte dhe prova të tjera plotësuese që provojnë shkeljen e mundshme.

Në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 798
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 02 ID dhe nr. 03 ID nga zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”

1. Pushimin e procedimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes ndaj z. Eduard Spahiu, Drejtor i Ujësjiellësit, Kukës, dhe disa funksionarëve të tjerë shtetëror për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 4

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

I.Horanlliu _____

M.Koja _____

A. Lamçe _____

Y.Merkaj _____

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 798
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 02 ID dhe nr. 03 ID nga zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”